


8SH-1
R 79



poezi

Petraq
Risto

**SYTE E DITES
VIZATOJ**

8SH-1
R 79

Petraq
Risto

**SYTË E DITËS
VIZATOJ**

poezi

SHTRIJU E RISTO PETRAQ

44465

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Redaktore
SEVIM ARBANA

Piktor
BUJAR MARIKA

Recensues:
Fisnik Sina
Skënder Buçpapaj

TIRANA

Kryeqyteti ynë i pabujshëm në një pikë të globit,
kryeqyteti ynë plot jetë si zemra brenda gjoksit.

Ka kryeqytete që njihen për kuriozitete,
për mrekulli që dehin turistë,
për reklamat e mëdha, për zhurmën, kabaretë...
Ngjyhen, pudrosen kryeqytetet e vjetër,
si aktoret e plakura që pasi zbrasin kuletën
të etura kërkojnë të luajnë Zhuljetën!

Kryeqyteti ynë i ndershëm, i paprekshëm
si flamuri i shpalosur në betejë.
Në baltën tënde të kuqe ke hedhur rrënjët,
si nën petale të bardha lulesh
nën mermer qëndrojnë të rënët.

Kryeqytet i pabujshëm, i vogli me peshë floriri,
i njohur në botë për besnikërinë...

Atdheu ynë, dihet, ka formën e syrit,
ku ti, Tiranë, ndrin si një retinë.

LIDHJET E MIA ME DETIN

Ju nuk i dini gjithë lidhjet e mia me detin,
ç'metafora marrim e japim me njëri-tjetrin.
Unë u rrita me spiralen e dallgëve të tij,
ai në gjakun tim gjithë dufin e erërave treti.
Pulëbardhat bien si theksa ritmikë mbi vargjet e
dallgëve,
në damarët e mi — poezia e detit.
Natën e kthimit ka shumë drita në shtëpitë e
detarëve,
në damarët e mi — çmallet deti.
Ju nuk i dini gjithë lidhjet e mia me detin
ç'metafora marrim e japim me njëri-tjetrin.

KUJDESTAR I DALLËNDYSHEVE

Kujdesem për të gjitha çerdhet e dallëndysheve
të ikura,
si një koleksionist i pasionuar kujdesem;
zogjtë nuk më premtojnë pasuri me cicërima
kur më lënë çelësat e artë në çdo fillim vjeshte.
Kujdesem për të gjitha çerdhet e dallëndysheve të
ikura
hyj në to, çlodhem, shkruaj vjersha...
(Dallëndyshja është e zezë
po gushën e ka të bardhë,
gushën ku rri kënga.)
Kujdesem për të gjitha çerdhet e dallëndysheve të
ikura
për bukurinë e tyre më është dashur dhe të
ndeshem,
kujtoj njeriun syhirtë si dy cigare të fikura,
kur desh të prishte një çerdhe.
Po do të vijnë zogjtë, i thashë, dallëndyshet do të
kthehen
si fëmijët e qeshur nga shëtitja e së dielës

dhe do t'u bëj një lutje, një lutje të vetme:
të të ngrënë një çerdhe
nën strehën e kapeles!

Kujdesem për të gjitha çerdhet e dallëndysheve të
ikura.

ISHTE DASHURIA

Fryu një erë e ngrohtë mbi lulet e qershisë
dhe të ranë mbi krela. Unë qesha e zogjtë

mbi krye
diçka thanë për ne të dy. Diçka të bukur sepse
në sytë e tyre të vegjël si yje pashë lulet e

qershisë
e fytyrën tënde të skuqur. Sa bukur që ishte!
Sa bukur! Dhe qershia si një vajzë nën vello
ëndërronte frytet e saj. Uji rridhete me qiellin

mbi supe,
me hijen e zogjve, me hijen tënde të bukur
e me dridhjen e ndjenjave të mia.

Ti mos hesht. Ti vrapo nëpër pyje dhe mblidh
mana toke në pyllin e gështenjave,
e më fol për natën e fejesës sonë,

për detin që na vinte me urtësinë e tij
për të na thënë diçka, një urim prej gjyshi.

Sa bukur, e dashur! Ti e njeh gjuhën e luleve
dhe gjuhën e zogjve; ti je dirigjentja e tyre,
e violavë dhe e sazevë të natyrës, e fyelli të çrës

dhe e luleve-nota nga nokturni i pranverës.
Fryu një erë e ngrohtë mbi lulet e qershësë,
një fyell i artë rrëzoi dy nota muzikore
mbi krelat e tua e mbi buzët e mia.

Ishë dashuria.

40 KILOMETRA LARG

Hyra në shtëpinë e re
40 kilometra larg nënës;
më thosh gruaja «pse s'gëzohesh, pse?»
... 40 kilometra larg nënës.

Ah, të ishte rruga si një metër
e ta mbidhja nga një orë për vete
që t'i shkoja nënës shpesh në prehër!

Duke thënë me zë këtë ëndërr...
Gruaja hapi derën.

Puthëm nënën.

SHKRIMTAR NË TEATRIN E KUKULLAVE

Jetoj në një botë të çuditshme metaforash
ku llamba bëhet diell, lulja-zile, loti-det
e ku fare natyrshëm çdo gisht shkëputet nga dora
e si Gishto i përrallës më flet.

Kukullat më ftojnë në shtëpitë e tyre butaforike,
ulem pranë Qerosit, Borëbardhës, Hirushes,
Guliverit

më qerasin me piye të çuditshme,
për tortë më nxjerrin një copëz ylberi.

Kukullat më tregojnë ndodhi të shumta
me shtriga, zana, katallanë, male e dete.

Ndodhitë tona do të bredhin në plane të, thonë
kukullat
çdo metaforë e hiperbolë tokësore

pyllëzimi i tyre do jetë.

Jetoj në një botë të çuditshme kukullash,
mbase nuk besoni po t'ju them:

në thellësinë e detrave kam njojur një sirenë
plagosur ëmbël nga fuzhnjet e arta të diellit:

me Borëbardhën jam njojur kur i ra nga dora
molla me helm,
balozin e mundur kam parë shtrirë në këmbët
e Gjergjit.
Jetoj në një botë kukullash, jam miku i tyre
u flas për jetën e njerëzve e shpesh s'më be-
sojnë.
Si mundet, më thonë, të flitet këtu për luftën
e yjeve
si mundet fëmijët të vdesin urie, si mundet,
më thonë.
Atëherë i bëj të ngjiten në skena,
të shprehin protestën e tyre,
me gjuhën time krijoj ura mes kukullave e
fëmijëve.

DAULLJA

Daullja, bija ime,
është një muze,
një shpellë,
një fole bubullimash,
daullja, bija ime.
Eja hyjmë në të,
bija ime,
qiellin — të rrumbullakët,
malet — të lartë,
fushën të paktë,
e kuqërremtë
si mpiksje flakësh,
daullja, bija ime.
Hyjmë, bija ime,
po kujdes se këmbët
mund të zgjojnë shekujt.
(Daullja mund të kishte
dhe një emër tjetër
për shembull — kushtrim
për shembull — zemër.)
Daullja, bija ime.

Dy motive me Batërflajin

BATËRFLAJ NË NJË KAMP PËRQENDRIMI

Kam qenë në një ish-kamp përqendrimi
tani, pas dyzet vjetësh.

Ciceroni fliste, në sy i shihnim
vizatime të holla skeletësh.

Çuditesha si në një kamp,
ku dhembja prej dhembjes nis të qajë
të burgosurit shfaqnin operën «Batërflaj».

Çuditesha unë, të tjerët rrotull,
dhe reja dhe zogu dhe lumi në krah.

Si mund të luhej një opera
dhe kush ishte Batërflaj?

Batërflaj ishte shpresa, më tha një vajzë,
mbijetesa e çdo njërit prej tyre,
Batërflaj ishtejeta pa aureola paraqje
po me fustan, lëkurë e zemër të shqyer.

Batërflaj ishte nga gjithë kombet
këndonte në një skenë ngritur me zemra
Kur ajo këndonte thyheshin idole
nga miliona thika përgjakej kuçedra.

VRASJA E BATERFLAJT

(Me rastin e 40-vjetorit të masakrës në Hiroshima dhe Nagasaki)

Madamë Batërflaj ishte nga Nagasaki...

Kur bomba atomike shkatërrroi qytetin,
kur ktheu në hi shtëpi dhe njerëz
madamë Batërflajn, thonë, nuk e gjeti.
Vallë ku kish ikur, ku ish fshehur?

Dhe bomba atomike, ca atome të saj
thonë kishin emrin e Pikertonit,
vërtiteshin në Nagasaki:

— Batërflaj! Batërflaj!
po nuk e gjenin fluturën që donin.
E kërkuan avionët, vaporët, retë dhe era,
e kërkuan të verbrit, të çalët, fëmijët e pafaj,
me pjalmin e djegur e kërkoi pranvera:

— Batërflaj, ku je, "Batërflaj"!
Mos je fshehum në ujërat që s'janë më,
mos je fshehur në këngët që s'aguan,

mos je fshehur te zogjtë që s'kanë zë
apo te kujtesat që harruan.

Apo vallë je fshehur nëpër pyje
me drerët brirartë bën shoqëri,
mos vallë strukur je nën ca nota muzike,
apo strehë ke gjetur nëpër poezi.

Mos je fshehur në rrënjet e diellit që po lind
në savanin e lumenjve që do rrjedhin
në kurora dafinash, në degë ulliri,
apo në zemrat që kaq mirë të fshehin.

Dolën ta kërkonin punëtorët, fshatarët
një pinjoll i Puçinit «do ta gjej!» u betua.
E kërkuan në Kili, në Kore, në Vjetnam,
në Nevada, Siberi e Mesdhe e kërkuan.
E kërkuan sopranot, tenorët, basët,
dirigjentët, kompozitorët, poetët pastaj:
— A keni parë një grua nga Nagasaki?
Batërflaj!

Batërflaj!

Batërflaj!

Dhe kanë plot dyzetë vjet që e kërkojnë
disa hiqen të lodhur, shfajësohen pastaj
dhe kënaqen, duartrokasin, argëtojnë
duke parë në skena ca kopje Batërflaj...



QYTETI MBIJETOI

(Në vjeshtën e vitit 1943, gjermanët e boshatisën qytetin e Durrësit, i cili qëndroi kështu deri në pranverë të 1944. Në qytet punonin vetëm pak punëtorë në portin e vogël dhe në fabrikën e miellit).

Shtëpitë ishin kyçur. Macet u bënë të egra.
Dhe bari çdo ditë zgjaste gishtërinjtë.
Në dyqane ishin ulur qepenat
dhe në vend të shitësve, lëviznin minjtë.
Rrugët për një çast humbën qëllimin e tyre
u kthyen në rebus,
për t'i zgjidhur nuk kishte së kush.
Shtëpitë ilegale më dritatë të mbyllura
si me dhëmbë të shtrënguara
heshtnin, kujtime duke bluar.
Heshtnin fotografitë në mure. (Disa prej tyre
Tani ishin dëshmorë).
Era luante me letrat si me fletë flugeri
të shkatërruara nga furtunat e kohës.
Vratat ishin pa zjarre. Hiri kish mall
për trazimin e mashës,

DITINDEK MESTI DITINDEK ALIDA DITINDEK MESTI

Alida është e njëjshëm i dashurë që leib e që i ruhet që
madje dhe të vdekurit në varre lule kujtimi kërkonin prej të dashurve.
As drita s'kish, as erë gjelle,
as këngë, as thashetheme,
as kükulla e topa prej lecke...
Po një mëngjes, një ditë
askush s'e di se si
një flamur i kuq
u duk si fluger mbi çati,
një flamur i vogël
sa një pëllëmbë gëzimi,
sikur kish çelur nga dhembja te çatia,
apo mbasë nga malli, nga dashuria.
Dhe qyteti qeshi. Shtëpitë lëvizën.
Lëvizën fotografitë në mure.
Një prush i kuq u ndez në vatrat,
kurse në varre pranvera
kish ndezur flakëza lulesh.

E DIELA

E bukur kjo e diel, e dashur. Me diellin si dhëndër,
me qiellin xheloz pér sytë e tu të kaltër.

E diela je ti, jam unë, kënga e fëmijëve në
mëngjes,
e diel është premiera e «Traviatës», aria e
Violetës,
ëndrrat nën shelgjishte, ethet e stadiumeve,
tingujt e kitarës, vallëzimi i parë, pritja e trenit të
largët.

E diel është plazhi me përparësen e kaltër,
një «urra!» që valëvitet në ajër,
ëndrrat, boritë e taksize,
muzjet me drurë pëshpëritjesh...
Gjithçka e bukur sot
qenka e diell!

DHËNDËR NË TË DIELËN E DIKURSHME

Im atë u bë dhëndër me rroba me qira,
rroba të çuditshme prej letre. Xhaketa prej letre,
prej letre jeleku. (Prej letre dhe lekët.)
Këpucët gjithash tu prej letre, si dy varka
që s'kanë njohje me detet.

Veç im atë ish prej mishi dhe kocke
dhe lotët, natyrisht, nga një qiell revolte.
Mbreti Luante letrash
mbi varret e të vrarëve dhe të vdekurve.
Dhëndëri — baba me veshje prej letre
në atë të diel të 38-tës.

FËMIJËT E LUFTËS

Flisnim për një mollë të plagosur nga predhat
dhe për një nuse me dhëndër të përgjakur,
pastaj merrnim gëzhojat e nxehta të pushkës
dhe ngrohnik trupin e mardhur.

Dikush na tha se gëzhojat bënин muzikë,
i vumë në buzë dhe fryma jonë dha tinguj.
(Mollë, shëroji plagët, qëndro e mos ki frikë,
dhëndër, merr prapë pushkën, qeshe nusërinë!)
Orkestra fëmijnore vraptonte nëpër rrugë.

Flisnim për vërsnikët dëshmorë
dhe në kapelen me arna gugiste një pëllumb i kuq
dhe në foletë e gëzhojave këndonin mijëra zogj.
(Dhëndër, shërohu, mollë, gjallërohu!)

GUASKË BOSHE

Ishte një muzg plot dritë në plazhin e bukur
me jetë orkestra luante në pistë dhe valët bënин balet...
Po qelqi i dritares papritmas u drodh
dhe balerinat valë në breg u stepën.
Përse po bërtiste yt shoq kaq egër?
Dhe dole në muzgun plot dritë
pe diellin që zhytej në detin e gjerë
i kuq si trëndafilat te fustani yt
që ai s'deshte ta vishje një herë.
Çiftet shëtisnin në breg, dielli mblidhë penelat e
artë,
anijet si ishuj dritash farfurinin tutje në radë.
Ti shkelje mbi guaskat pa jetë, mbi xhelozinë —
guaskë.
E qetë u ktheve pastaj. Yt shoq ish fashitur.
Si trëndafil në maj, i the për diellin e zhytur.
Në fustanin tënd trëndafilat lulëzonin nga
dashuria,
po ai heshte i ngrysur. Guaskë boshe —
xhelozia.

Eja, dalim, i the, dalim bashkë, qenka i bukur
ky muzg ne jemi të rinj, dhe plazhi s'do njerëz të zymtë
si murgj.
Ai qeshi lehtë. Ca guaska u thyen nën këmbë,
valët bënин balet veshur me fustanet e hënës.

LINDJA E METAFOREËS

SHTRIJNTE
SUTATPINI E MARXIT

Vajza ime i vuri diellit mustaqe dhe e bëri
xhaxha,
e përqafonte, e puthte si të ish e qielte,
pastaj zogut të vogël, mos qaj, i tha
dhe i ngriti fole te një dallgë në det;
dhe një tren shumëngjyrësh, natyrisht jo pér
shaka,
e bëri të rendë mbi trasenë e ylberit.

HITLERIANËT DOGJËN SHTËPINË E MARKSIT

Shtëpia digjej. Shkrumboheshin orenditë. Librat. Tryeza e punës. Gazetat. Fotografitë. Lumi Mozel furishëm tek kalonte la shtratin dhe erdhi të ndihmonte shtëpinë. Dhe kodrat e Tririt — erashka të hapura u përpoqën të shuanin zjarrin e zi. Nga Porta e Zezë dhe kisha romake dilnin mitet, legjendat dhe bënin habi. Dhe kur hitlerianët i gëzoheshin shkatërrimit banorët thanë u ngrit një Marks prej zjarri tundi mjekrën e kuqe, u bë sfond agimi, krijoi zemra të reja te proletari.

Trir 1980

FRYRËSIT E QELQIT

KJM LYL BT

E dimë që rëra vjen nga deti
e dimë që qelqi bëhet nga rëra
po shumë pak dimë për fryrësit e qelqit
sepse s'mund t'i dimë të tëra.
S'mund të dimë se duke fryrë qelqin
ai zgjon detin, loz me fryshtat e tij,
merr dy dallgë i bën mushkëri.
Fryrë mbi qelq si era mbi shkulme,
fryrë si një orkestër me guaska deti.
Kështu nga gjoksi i tij
qelqi bëhet rrugull, fryt, lule...
Dhe ne mësojmë diçka për fryrësit e qelqit.

TË HYJ MIK

Pranoj të hyj mik për ta bërë ylbérin të vallëzojë
dhe detin të flasë dhe pemët të këndojnë. Pranoj.
Po mos më thuaj të hyj mik aty ku s'duhet
se ylberi si fije kashte do digjej, pemët do heshtnin
dhe deti si faqe e plakur në çast do rrudhej.

Pranoj të hyj mik për ta bërë foshnjën të flasë,
lulen të dashurojë, hojen e shpirtit të pikojë.

Pranoj.

Po vetëm mos më mundo me fjalën fënde të
plumbtë
që do të ma vriste poezinë. . . Kaq kisha. Po shkoj.

ECIM

Rruga është e gjatë, po ti eja, e dashur.

Eja. Të pres.

Nga pritja dhe ora merr formën e zemrës.

(S'e lëvizin ingranazhet, po gjaku.)

Mëngjes.

Eja! Nga cicërimat e mëllenjave u artësua mëngjesi
dhe qelli tingëllon si kupë kristali.

Eja, e dashur. Si shega e pjekur po çahem nga
malli.

Ecim. Kemi diellin me vete, shokët dhe këngët,
kallëzatëndërrimtare, zogjtë dhe të rënët.
(Më shumë se bota

amaneti qenka i rëndë!)

Kështu do ecim në këtë rrugë,
nëpër shkallë mëngjesesh,

jo shkallë,

po supet e brezave!

BUSULLA E DETARIT PLAK

Ai merrte frymë ngadalë
si një det i fashitur.

Koka e bardhë si një ishull korali
lëvizi pak mbi jastekun e ngritur.
Diçka foli me pëshpërimën e valës në breg
dhe më zgjati duart e rreshikúra
me një busull të vjetër.
Në kokën e bardhë
jeta zu të tretet.

M'u ndezën lotët nga të qarët
ranë mbi xhamin e búsullës së vjetër...
Shigjeta lëvizi si gishti i detarit,
mbase kripë e lotëve i kujtoi detin.

QERSHIZA

Ishite vapë. Mbi driza-lékurë gjarpérinjsh.
Ajo vraponte drejt nesh me dy yje në sy
dhe me një shportë plot dritëza qershish.
Erdhi me një frymë. Buzëqeshte si fëmijë.
Sa e pastër ishte, si një zjarr pa tym,
si fjala liri.

E quajtëm Qershizë. E vogël ishte
sa një degëz qershie. Me dy faqe të kuqe.

Dhe e zuri gjumi në lëndinë
në prehrin e një partizaneje.

Kur qeshte nëpër ëndrra, sikur shkundte qershinë,
sikur brenda frytit fuste dhe freskinë dhe zjarret.

Kur e zgjuan plumbat, ajo nuk u tremb,
por në shportën e vogël mblidhët gëzhoja.

Sa e pastër ishte, si një zjarr pa tym,
e pastër si fitorja.

KLAKERËT¹⁾ KTHEHEN NË SHTËPI

Kthehen të lodhur. Duart e buhavitura kërkojnë
ujë me kripë
Lehtësohen ca duart, sikur zbrazin duartrokite
në enën e ftohtë.
Duartrokit. Duartrokit. Duartrokit.

Kthehen të lodhur. Me një pagë të vogël
në xhep të ironisë.
Bëjnë të flenë, po sytë nuk bien dakord me duart.
**Sytë...
Duartrokit. Duartrokit. Duartrokit,**

Nuk është mirë kur grinden sytë me duart.
Në sallë ne shpesh ndiejmë dhembje, thonë sytë,
dhe habitemi me gëzimet tuaja. Singarisht.

1) Klaker quhen njerëzit në vendet kapitaliste, që paguhen për të duartrokitur çdo shfaqje, pavarësisht nga cilësia e tyre.

Sytë thonë fjälë tē mençura. Duart
tē zhveshura si gënjeshtra.
Ç'të bëjmë, thonë duart, s'jetojmë po tē rrimë
heshtur.
Duar apo sheshe nën breshër?

Nuk eshtë mirë kur grinden sytë me duart
aq më keq që në mes kanë zemrën.
Zemra e tyre — dashuri e vonuar, dhembje e
vjetër.
Kur sytë thonë tē vërtetën dhe duart gënjejnë
s'kam ç'të bëj tjetër, veç tē plas, unë, zemra e
shkretë...
Klakerët kthehen në shtëpi, tē trishtuar si
proverba pa jetë.

ÇUDITË E KËPUCEVE TË TIM BIRI

Im bir i grisi këpuckat e para
brenda shtëpisë, brenda çerdhes i grisi;
si kokë breshkëze më sheh, i bukur, gishti.

Këpuckat e vogla, të kuqe
do t'i ruaj si relike,
i lë diku, po ato papritmas, si fara
marrin dritë ëndrre, çelin sythe, rriten.

Lindin çuditë e këpucëve të tim biri
si në përralla këpucët magjike.
Këpucët ecin, vrapojnë, vallëzojnë...
Njëqind këpucë flasin me udhët,
udhët e tim biri përreth më zhurmojnë.

(N) *Minimizing a Risky Project*

Kaq shumë këpucë magjike para meje bëjnë
hapa,

rrotullohen në piruetë, ngjiten, zbresin,
me një krenari të çuditshme unë u shkoj
mbrapa
i shoh dhe uroj të ecin, të ecin.

TI SHKON PËR GJAH

(Një miku që e njoh prej vitesh)

Sot vare çiften te gozhda e harresës,
na dëgjo ne shokëve, miqve të vjetër.
Ti shkon për gjah në pyjet me borë,
nga bukuria një «ah!» çel kraharorin.
Ti shkon për gjah të shtunën, të dielën:
pesë rosa me krahë të kopsitura në qiell,
pesë lepuj të vegjël si prej dëbore të ngrohtë,
një dre me brirët — skicë rrufeje e ftohtë...
Po sot vare çiften te gozhda e harresës
dhe ne punëtorëve më shpesh na tako,
të na zgjidhësh hallet, nuk qenka e lehtë
saçmja e çiftes s'i zgjidh dot ato...
Dhe pastaj kur të lodhesh
nga kjo luftë e vërtetë
mund të shkosh dhe në gjahun e rosave,
dhe ku brirët e drerit imitojnë rrufetë.

KORBAT

MINHA Q HIRSH

SH-OB TETT SH AVTIV

Korbat krrokin kur mblidhen retë,
kur bie shi dhe fryn erë.
Pastaj zhurmojnë si fallxhore te sheshi
sikur shohin falle me sytë djallëzorë.
...Për të qenë më të qartë kujtoni borgjezin
si lut «parajsën» çdo ditë e çdo orë.

Dihet që korbat ngordhin në vjeshtë
me gjethet bien dhe mijëra krrokutje
ndaj fisi rri veshur me rroben e zezë
kur bën proçesionet mortore në qiell.
Gjithmonë takohen, shoqërohen me qyqet
i ftojnë të vijnë e t'u bëhen vajtojca.
...Për të mos e zgjatur kujtoni armiqtë
kur shpresëhumbur largohen nga ditët
dritëvjollca.

NJERIU QË HIQEJ

T A C H O Z

DON KISHOT NË VITET 30-të

Në fillim njerëzia qeshte, fëmijët e qëllonin
me gurë, xandarët tregonin lloj-lloj barceletash
për Don Kishotin e sëmürë.
Po një mbrëmje të bukur me hënë,
kur hëna Dylqinës i ngjante,
Kishoti i rebeluar mes një hani kish thënë:
në dhomë i kish ardhur mbreti dhe qante,
para Don Kishotit vetë mbreti po qante...
Njerëzit ngrinë. Muret tundën supet, gati râ çatia,
xandarët rendën si të ishin xhind
drejt Kishotit rendte mbretëria,
Kishoti kishte tallur mbretërinë.
I pandehur! I pandehur! I pandehur!
Ke ngatërruar ministritë me mullinjtë e erës,
kënetat me qiejt e parajsës,
priftërinjtë e hoxhallarët me fuçitë e verës
dhe sytë e drejtësisë me sytë e kukuvajkës,
I pandehur! I pandehur! I pandehur!

Ke thënë për parlamentin — bretkocat para shiut
për paratë ke thënë — bixhozë të mbretërisë,
ke ngatërruar burgjet me skenat e muzikës
për rrugët e reja — ushunjëza të Italisë...
...E rrahën të gjorin, e rrahën kaq shumë
saqë harruan metamorfozën:

Ishte kthyer në Sanço.

ORA E VJETËR

Motrat duan të blejnë orë të re
po nëna s'pranon. S'di sepse.

Ora e vjetër tik-tak mbi tryezë
patjetër diçka flet me të.
Vëllezërit duan të blejnë orë të re
po babai s'pranon. S'di sepse.

Ora e vjetër tik-tak mbi tryezë
besnikërisht numëron kohë të re.
Kur qëllon ora e vjetër të prishet
te orëndreqësi shkojnë prindërit të dy,
sikur kanë ngecur kujtimet
në orën mbështjellë me shami.

Ndaj nëna dhe babai shpesh më duken
si akrepat e një ore të madhe
herë mbyllen ngadalë si në puthje,
herë hapen si krahë përqafje.

ME MOISIUN NË VJENE

1.

Moisiu ecën midis nesh
dhe hëna e kuqe
si unaza e Inflandit
digjet në qiellin vjenez.

Kujtojmë kur dhjetra vjet më parë
jetonte këtu i riu Aleksandër,
zambaku nga uji i sapodalë
duart buaviste nga puna si klaker.

Në këtë qytet të pastër
me pëllumbë të hirtë
i dikurshmi klaker
si gjeni u duartrokit.

2.

Për sytë e tu kur flasim,
për sytë me rrënjet te dielli i jugut
në qiel si në një telajo të madhe
skicohen dy zogj të bukur.

Dy sytë e Fedias,
dy sytë e Hamletit,
dy sytë e Edipit,
dy sytë e Faustit,
dy sytë e Mefistofelit...
Qindra sy
të fokusuar në dy.

PYLLI NË PRANVERË

Unë nuk jam dehur ndonjëherë
as nga rakia, as nga suksesi,
po shpesh, o miq, më deh pranvera
dhe kënga e zogut të mëngjesit.
Më deh pikimi i qershisë
dhe punë e bletës mbi kurorë
dhe vrap i ketrit nëpër pishë
gjithë pylli plot si me dasmorë.
Ja ku po vjen thëllëza-nuse
ky gjeli i egër zë thërret,
shurdhohet vesh' i dhelprushes
që kokën nxjerr nga strofk' e vet.
Në shesh të pyllit fillon dasma
të veshur gjithë me ngjyra-ngjyra
si panair me mijëra basma
duket në pranverë natyra.
E cërl, cërl, cërl
e ciu, ciu, ciu
nis orkestrina: curle, dajre,
yallen shtruuar hedh ariu,

shaminë djeg një nuse lale.
Bilbili qesh e loz në bar
dhe e njomë këngën, oh, me vesë
pastaj vjen dreri brirë-ar
në brirë yje çel mëngjesi.
Shkoj mes pyllit i gëzuar
e kafsh' e zogj ma bëjnë me sy...

EKLIPS

AMRAQ SHATI

SHOL-UNI NI RYATPONA

Hyra te komshiu në shtëpinë pranë
të vishja xhamin e vogël me tym
dhe pashë një grua, një grua që qante
dhe burri i kish kthyer shpinën.

Pse qante? Mos donte të shihte
diellin e bukur me xham.

Po ai, ç'mendonte pas shpine,
pse kishte një heshtje alarmi.
Vrapova dhe dola në rrugë
dhe nisa vrojtimin galaktik,
po në qiell një fytyrë gruaje
më shfaqej në vend të eklipsit.

Mes diellit dhe tokës hyri hëna xhelozë
dhe ne i gjëzoheshim eklipsit të saj.

Ktheva kokën nga dritarja ngjyrë blozë
dhe iu luta gruas, iu luta — mos qaj!

Se ti je dielli, mendova,
pak çaste të zë hëna e ftohtë.

Nga bota fëmijnore atë dramë e kuptova
për xham të tymosur kisha lotët.

TETË DASMA

SHQIPTARE NË NJU-JORK

Nju-Jorku nga lartësitë e qiellçarësve rrokullis ortekë psherëtimash, pabesish dhe lotësh po një të diel vjeshte tetë dasma shqiptare ia ndërruan pak shijen Nju-Jorkut.

Tetë dasma ngjyrë bozhuri e aromë trëndeline katër nuse-motra mjegullash alpine katër dhëndurë-vëllezër suferine dhe shqipja e flamurit në mes.

Tetë dasma me dasmorë kuqezi katër nuse-zjarr e vesë gatuar me magji, katër dhëndurë me vetëtima thellë në sy dhe shqipja e flamurit në mes.

Nju-Jorku pa nocionin natë-ditë i lodhur, i drobitur gogësin si një luan i plakur

i ndal një çast gjithë zhurmat, pabesitë e
mrekullitë
dëgjon tetë daulle dhe një këngë të largët.

Katër nuse
si katër legjenda të lara me argjend,
katër dhëndurë
si katër balada me plagë në dhembje
dhe shqipja e flamurit në mes.

FRYN NJË ERË

Po fryn një erë
pa shih si fryn,
një re si velë
gjith' qiellin shtyn.

Jo, nuk është erë
po fryn një mall,
një re si velë
më sjell vërdallë.

Dhe pres e pres
me dritë në sy.
një rrufe ndez,
të skicon ty.

NJË MOLLË NË DHOMËN E HOTELIT

Ai erdhi në mesnatë dhe iku në àgim,
s'e njoha cili ish, ku shkoi s'e di.
Veç një mollë e kuqe yjon mbi komodinë
e ndritshme si zemra e tij.
Qëndroj përballe një molle të zakonshme
që ma mollëzoi gjakun, më la gjurmë të thella.
Çfarë je ti, e pyes, urtësi e moçme?
Pasqyrë fisnikërie? Një proverb i kthjellët?
... Ka pasur mollë të Adamit,
mollë të Njutonit,
mollë të Vilhèlm Telit.
Qenka dhe kjo mollë mirësie
në dhomën 12 të hotelit.

ÇERDHJA BOSH

Cerdhet ndër plepa
dallojnë mirë në dimër,
në dimër kur mungon kënga e zogjve...
Këto mendoj tanë në sallën e gjyqit
ku qëndroni përballe
si dy shkulme dëbore.

Dëshmitarët. Pastaj fajësia e dyanshme.
Dhe çerdhja bosh te plepi tej dritares.

SA SHUMË ZOGJ! (ARTIKULATUR)

(H. KRISTI)

Sa shumë zogj
si pëllëmbë të hapura
shtyjnë kupën e qiellit,
zogj të palodhur-korjerë poetikë
mes tokës dhe diellit.

SA SHUMË ZOGJ!

Si pëllëmbë t'ë hapura
shtyjnë kupën e qiellit,
zogj t'ë palodhur-korjerë poetikë
mes tokës dhe diellit.

Si pëllëmbë t'ë hapura
shtyjnë kupën e qiellit,

zogj t'ë palodhur-korjerë poetikë
mes tokës dhe diellit.

Si pëllëmbë t'ë hapura
shtyjnë kupën e qiellit,

NJË LUMË NË VËRË

(Peizazh)

Një lumë në verë gjithnjë shikon nga qelli
gëzohet me një re, kërcën me një vetëtimë.
Një lumë në verë duket sikur fle
veç bubullimat ia trembin letargjinë.

Një lumë në verë është tepër modest
dhe pikës së shiut i thotë «faleminderit!»
Një lumë në verë çmësohet dhe të ecë,
kujton ditët kur me brigjet ndizte sherrin.

Një lumë në verë pikëllon shelgjet që kërkojnë
pasqyra,
gëzon fëmijët që lozin me të si me një mëz të
shtruar.
Një lumë në verë... Po papritmas nisin shirat
e ai harron gjithçka si një kalë i harbuar.

PRANVERË

Mos, më fol, Lermë të shoh jargavanin
që gëzon si fëmijë te krahët e flladit,
të shoh detin që vjen si lajmëtar festiv.

Mos, më fol, Lermë të dëgjoj pemët mbushur
me zogj
nga buron-muzika plot gaz (pi su ngrënët tokët ose
(A thuaj me rrënjet në tokët është përbërë që ngrënë
kanë lulëzuar drejt qiellit kontrabasët?)
Sa poezi ka kjo pikture në telajon, e muzgut,

Tani më fol për çdo gjë tjetër të bukur.

TUTJE PO XHIROHET NJË FILM

Tutje po xhirohet një film. Në ecim buzë detit.
Hëna këputi lulëkuqen e muzgut, mes dallgëve
e treti.

Mbase ky film flet për jetën tonë, për shokët
tanë, mbase flet për anijen time në dialog me oqeanin,
për pulëbardhat në breg si stërkala malli.
Apo flet për kthimin e detarit,
për pritjen tënde te gjiri i merakut,
ku unë hedh zemrën-spirancë
nga dashuria përfshakur.

Tutje po xhirohet një film:

PALAÇOT E MBRETIT I MASIUT

Kur vdesin palaçot mbretërit trishtohen,
po arkivolet ngajnjë më skenë komikë,
të duket sikur vdékja inskenohet
për të zhveshur një çast palaçerinë e mbretërive.
Mbretit i pëfqente kurrë palaçojá lëzta më qenin
dhe i vinte mbi krye dëgën e dafinës,
kur shponte gishtin tregues dhe pikonte gjak
«Çdo pikë gjaku; thoshtë, balsam pér madhérinë».
Palaçojá vdiq në mbrëmje kur hëna queshte si
kurrë njerëzit në bälló lozni me shikimin e
kur në thillësinë e mitit Pons Pilati
u lantë duarve gjakun e nxehë.
Palaçoja vdiq në mbrëmje dhe balloja s'u ndërpri
dhe Pons Pilati vazhdoi t'i lantë duart
veç hëna nga garderoba e saj plot re
huazoi një qefin mbi palaçon e shëmtuar.
Kur vdesin palaçot mbretërit trishtohen
se s'mund të rrojnë pa palaçëri.

SHPOETIZIMI I YJEVE

Dhe yjet i shpoetizuan.
Nuk janë më as-gonxhe lulesh, as luzmë bletësh,
as sy të dashuruar, as pika mbi «i» si hëna e Mysesë.
Sot superfuqitë shpoetizojnë dhe yjet që s'mund t'i karahasosh me sy fëmije,
as me zile tingëllimtare, as me dritare freskie.
Yjet mendohet të jenë sheshe lufte.
(Poëtë, fabrikoni figura të reja për galaktikat e pafundme!)
Galaktikat mund të ngjajnë me kërpudhat e shpërthimeve atomike,
yjet mund t'i krahasoni me grimca hiri,
hëna mund të bëhet një Neyadë e mrekulluese...
Po shpoetizohen yjet!
Po njerëzimi?!
Njerëzimi, jo! Jo, njerëzimi!
Se ja, grushtet kanë krijuar galaktikat e revoltës
dhe kur hapën gishtërinjtë e të vrarëve
krijojnë yje të rinj.

BUKA E GJAKUT

Sofra ishte e madhe dhe e kuqërremtë si dielli.
Burrat vinin hijerëndë e të heshtur
mbuluar nga perdja e tymit të duhanit
si nga një perde tragjedie.
Uleshin burrat dhe përtypnin kafshatën e bukës
sikur përtypnin dhembjen e tyre,
sikur përtypnin gëzhojat e nxehta të pushkës.

«Falë qoftë gjaku i axhës!
Falë qoftë gjaku i gjyshit!
Falë qoftë gjaku i babës!
Falë qoftë gjaku i tim biri!».

Sofra e madhe dhe e kuqërremtë si dielli.
Të nesërmen kish luftë
me armiqjtë që po nxinin.

NËPËR DIELL BIE SHI

Këngë

Nëpër diell bie shi,
rrugës ecim unë e ti,
gëzon reja me borë,
era hipur mbi dori.
Nëpër diell bie shi.

Nëpër diell bie shi,
dielli ma bën me sy,
loz-unë e loz-ai,
loz dhe ti, moj, dashuri,
Nëpër diell bie shi.

Nëpër diell bie shi,
dielli dërgon krushqi
sa të rritet grur' i ri
ta vë vellon si flori.
Nëpër diell bie shi.

KALI I ZI

Ai s'e harron atë kalë të zi — pjellë e natës,
hipur mbi të një njeri
më fytyrë hënë të përbaltur.

Ai s'e harron atë kalë të zi
dhe njeriu shpirtzi që kamxhikonte vazhdimisht.
Ai s'e harron. Katër vjet liri.
Po kali i trokonte lokomotivës përbri.

I ziu, kalë i zi!

Hyjo! Hyjo! Hyjo!

Thërriste njeriu me natën mbi supe.

Më shpejt! Më shpejt! Më shpejt!

Thërriste trenisti i pjekur në zjarrin e luftrave.

Ish një kalë i zi, i zi si vdekja pa lotë e vaje,
i zi si nata me pendë korbi e sy kukuvajke.

Hyjo! Hyjo! Hyjo!

Ish një sfidë e zezë në formë kali,

ish një kalë i zi në formë sfide.

Ndaj nuk duroi,

trenisti i pjekur në zjarrin e luftrave,

ai që kish në duar të ardhmen, nuk duroi

IS LLAZI

dhe qëlloi mbi njeriun me natën mbi supe,
mbi kalin e zi, qëlloi.
Dhe kali ra, pa hingëllima u rrokullis,
u rrëzua dhe njeriu shpirtzi.
...Treni rendte në hekurudhën e lirisë
dhe kali në formë sfide po vdiste përbri.

AI S'ESHTË MBRET E S'E THERRASIN LIR

(Gjyshi)

Ai s'është mbret e s'e thërrasin Lir,
as kështjella, as kalorës, as ulërima mes erës,
nuk ka tri vajza po vëç një bër
që e dëboi tej pragut të derës.
Një bir plangprishës, sarhosh të pështirë
që harroi dashurinë prindërore.
Ai s'është mbret e s'e thërrasin Lir
si Liri s'mallkon e si Liri s'dënöhët.
Shtëpia e përqvë-kështjellë kujtimesh,
infermerët-Kördelja e mirë...

AI S'ESHTË MBRET E S'E THERRASIN LIR.

ERA

(Baladë)

Si një kalorës vrapon era,
në dorë mban vetëtimën — shpatë
dhe më përplaset tej te dera,
ma shtyn me forcë e me inat.

Po rri, moj erë, ç'më prish qetësinë
apo je lodhur e ke gjumë?
Kalorësja erë bërtet e shfrytë
«Pa hapma derën se kam punë!».

Një çast e la shpatën te retë
dhe flokëlëshuar hyri brenda
vërtitej rrotull meje, sertë
se dilte nga një gjoks me brengë.

«Kam tri orë që bredh në pyje
që hyj në fusha, guva, shpella

që shpesh vajtoj si mijëra fyej,
si brirë alarmesh në kështjella.

Po nuk e gjej dót, s'e gjej dot
babanë tim, të mirin Diell.
Fjala e saj m'i thau lotët
dhe qesha më një zë fëmije:

«Po prit, moj erë, ja tej dritares
një këmbë drite Dielli hedh,
po zbardh dhe bora nëpër male,
dhe zojtë u zgjuan nëpër çerdhe».

Dhe era e bukur, flokëlëshuar
u sul me vrap, pa përshëndettur,
te retë shpatën kish harruar
dhe grunjërat krihte me krehër.

VDEKJA E PABLO NERUDËS

Dymbëdhjetë ditë pas grushtit të shtetit,
vetëm dymbëdhjetë
në Santa Maria¹⁾ rri shtrirë poeti
plagosur nga dhimbja e Kilit të vet.
Hapi dritaren.. Mirë, se erdhe, i thë poezisë,
urrejtja është bombë e shpërthen patjetër,
sot kur trëndafili veshi kostumin e zisë,
kur Ishulli i Zi²⁾ u bë sinopim i vërtetë.
Neruda sheh re të vogla në qellin e njomë
si njolla boje në pëllëmbën e shkollarit.
Ç'ke shkruar, djalosh, në fletën e hapur të kohës,
ç'po shkruan në sytë e hapur, të të vrarit.
Të jesh poet, të këndosh si zogu, pa marrë urdhër
dhe armatën milionëshe të urdhërosh
që grushtet t'i shpërthejë përmbi juntën
dhe zemrat si kalldrëm lirisë t'a shtrosh.

1) Spitali ku vdiq poeti.

2) Këtu kish studion e tij poeti. Amëneti i tij ishte që të varrosej në këtë ishull, por junta ushtarake nuk e pranoi një gjë të tillë.

Mos qaj, Neruda. Dhe pse lotët e tu
kanë vlagë vargjesh, mos qaj.
Neruda, Neruda,
Neruda, Neruda!
Ti ishe njeri prej gjaku dhe dheu prandaj,
prandaj vdekja dot s'të mundka.
Thotë vdekja: s'jam e zonja të të mbaj!
Yjet të hapur, të ngirirë si sytë e të vrarëve
si sytë e Alendes, si sytë e kilianëve
(këto sy formokan qiellin e të gjallëve!)
Neruda, Neruda!
Të varrosën në Santiago e jo në Isla Negra
(Për Isla Negrat krahëlulëzuar vinte amaneti)
ndaj shkulme protestash ngriti deti,
një trumbë zogjsh u ngritën lart, të egër,
çukitën nëpër sytë e Pinoçetit.
Junta... Junta... Junta... ta... ta!
(po mitralon kujtesat që s'mitralohen)
Përmendoren e bardhë në vendlindje ta shembën
përmendoren e sheshit
e jo të zemrave përmendore.

Junta... ta... ta! Junta... ta... ta... ta!

Flatroj legjenda: ta hapën varrin dhe tē moren
dhe tē shëtitën nëpër Kili rrugë më rrugë
dhe prapë një laps tē ri tē vunë nē dorë
se vargjet t'i kërkojnë pér ujë e bukë
Oh, sytë e tu, Neruda, ishin qiell
ku fluturonin mijëra zogj si èndrra,
ku vrullin mërrte një balonië fëmije,
ku si letër mbi tréyze zbardhte hëna.
Neruda, Neruda,
si pé plumbci janë vargjet e tua
miliona njerëz i mbajmë nëpër duar
që godinën e kuqe madhështore ta ngremë.
Neruda! Neruda! Neruda!

ÇMINIMI

Poemth

Ai ishte i ri, i freskët —
vëlla mëngjesesh.

Dhe minat ishin me gjemba
si topuzët e balozëve në legjenda.

Çminuesi ishte i ri
po vdekja gjëmbonte rërën ed bardhë,
gjëmbonte detin e kaltër.
Dukej se shkretëtira kish ardhur
të mundte dheun e gjallë,
të bukurin dhé të gjallë.

Çmino bregun e artë
si saze në buzë të detit,
çmino udhët e verës
ku njerëz të lumtur do ecin.
Çmino motobarkat të vogla si opinga
dhe bëja gati verës që t'i veshë,
ë të ecë me to mes detit valëgrigja

e yjet tē trazojë me kërrabë direkësh.
Do lundrojnë anijet deteve, oqeaneve
e nē kujtesa kapitenësh, detarësh, nostromësh
do tē shfaqen ditët kur nē fundin e skafeve
përgjonin minat si topuzë balozësh.

Hapi minën e parë.

Skenë e çuditshme. U step.

Atje, brenda minës, ~~poçtë~~ pa një farsë me një mbret.

Thellë nē zemrën e minës
ishte mbreti me motrat lozni e qeshnin përkrah Geraldinës
me sy dhe shpirtra tē ndotura.

Djaloshi pështyu mbi minën e parë
dhe mbreti i zvogëluar njëqindfish, u tkurr
dhe Geraldina akoma me barrë
kujtoi udhëtimin me jaht, dikur...
Kur ajo èndërronte Venecian
dhe plazhet gati magjikë
vetëtimat tē xhindosura u ndezën
dhe deti u bë nevrik.
Ndaj e kthyen timonin e jahtit
dhe sërish nē Durrës, nē mesantë.
S'kish as rojënderi,
as fytyra servile pallati
veç dallgët e këtij deti... injorant!

Qielli skuqte si një kudhër e nxeh të,
farkëtohej mëngjesi i ri.
Ai çapitej bregut me pulëbardhat mbi kasketë
me vdekjen shtrirë përbri.

Zhvidhosi minën e dytë
të ngjashme me kokën e Duçes
dhe brenda në të pa simbolin fashist,
sëpatën e Liktorit që strukej.

Ku të futej?!,
Para tij simboli po pshurrej!

Çminoi rrënjet e një trëndafili
dhe gonxhja «dashuromë!» i tha qillit,
çminoi një këngë te Shkëmbi i Kavajës
ku me bubullima mbi beun qëlloi fukarai,
çminoi folenë e një dallëndysheje,
bohçet dhe halat e një pylli prej pishe.
Çminoi guvën e një kitare
fluturuan mijëra zogj notash,
erdhën fëmijët dhe me rërë të lagur
ngrinin në breg kështjellat si torta.
Pastaj të dashuruarit të dridhshëm si yje vere
putheshin e putheshin-krijesa prej ere.

Zhvidhosi minën e dhjetë,
Një shtëpi publike kërruset brenda saj
dhe ca ushtarë fashistë me benevrekë
vrapojnë e s'dinë ku vrapin ta mbajnë.
Ai pështyu mbi laviret dhe pushtët,

pështyu mbi moralin e tyre të kalbur.

Mina pa vdekje shtrihej si një bushtër
e nxirë nga të rrahurat.

Në një minë ish fshehur Gjenerali Dimër,¹⁾

Gjenerali Dimër me spaleta akulli

bënte ecejake në dhomëzën e minës

dhe priste të shpërtente zemërim-acarin.

Çminuesi qeshi, çgradoi në çast Gjeneralin,

çgradoi ushtritë e zeza, borën e zezë

sipas urdhërit bleronjës të malit,

sipas urdhërit jetëdhënës të pranverës.

Minati pa vdekje

si kufoma të qelburab

në morgun e turpit rreshtoheshin sërë-sërë.

Dhe lindi dita e re

pa mina, pa ofshama e përcartje.

Anijet e vogla, të lehta si re

lundrojnë mbi gostinë e kaltër të dallgëve.

Çminuesi pa si erdhën dhjetëra vera

me rrobe prej rëre të bardhë,

me vello prej deti të kaltër

Gjenerali Dimër — kështu e trumbetuan hitlerianët Operacionin e Madh të Dimrit 1943-1944.

dhe mijëra njerëz i pritën te dera
e u thanë si nuseve-mirë se erdhët!
dhe u ngjyen gishtat e bukur me mjaltë
e u hodhën yje si karamale në dasmë.

Dhjetëra vera me mijëra diej mbi supe
me miliona zemra kraharorëve plot jetë,
me mijëra vajza si Afërdita prej shkume
me mijëra djem.

Deti në buzët e dallgëve
mban sazen e artë të bregut.
Çminuesi hedh hapat e lumtur plazhevë
me gëzimin e jetës në sy,
me pulëbardhat që lozin mbi kasketë.

the people who are living I should like to see
the world as it is now is better than a
better one which is hardly ever going to be
better for the people in the world is a

good place to live in because there is
nothing better than the world we have now
we will never have a better world than this
one we have now because it is the best we
will never have a better world than this

the world is a good place to live in because
there is nothing better than the world we have now
we will never have a better world than this
one we have now because it is the best we
will never have a better world than this

PËRMBAJTJA

Tirana	3
Lidhjet e mia me detin	5
Kujdestar i dallëndysheve	6
Ishte dashuria	8
40 kilometra larg	10
Shkrimtar në teatrin e kukullave	11
Daullja	13
Batërflaj në një kamp përqëndrimi	14
Vrasja e Batërflajt	16
Qyteti mbijetoi	18
E diela	20
Dhëndër në të dielën e dikurshme	21
Fëmijët e Luftës	22
Guaskë boshe	23
Lindja e metaforës	25
Hitlerianët dogjën shtëpinë e Marksit	26
Fryrësit e qelqit	27
Të hyj mik	28
Ecim	29
Busulla e detarit plak	30
Qershiza	31
Klakerit kthehen në shtëpi	32
Çuditë e këpucëve të tim biri	34
Ti shkon për gjah	36
Korbat	37
Njeriu që hiqej Don Kishot në vitet 30-të	38
Ora e vjetër	40

Me Moisiun në Vjenë	41
Pylli në pranverë	43
Eklips	45
Tetë dasma shqiptare në Nju-Jork	46
Frym një erë	48
Një mollë në dhomën e hotelit	49
Cerdhja bosh	50
Sa shumë zogj!	51
Një lumë në verë	52
Pranverë	53
Tutje po xhirohet një film	54
Palaçot e mbretit	55
Shpoetizmi i yjeve	56
Buka e gjakut	57
Nënër diell bie shi	58
Kali i zi	59
Ai s'është mbret e s'e thërrasin Lir	61
Era (baladë)	62
Vdekja e Pablo Nerudës	64
Çminimi (poemth)	67

Risto, Petraq

Sytë e ditës vizatoj: Poezi / Petraq Risto;
[Red.: S. Arbana]. — T.: Naim Frashëri,
1989. 76 f., 18 cm.

891.983-1

R 79

Tirazhi 1500 kopje Formati 49x78/16 Stash 2204-82

Shtypur Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «ë Nëntori» — Tiranë, 1989